

VENDIM
Nr. 835, datë 26.12.2024

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 412, DATË 15.6.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË
KAMZË DHE LEZHË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 412, datë 15.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, nga Bashkia Lezhë, në masën 10 024 380 (dhjetë milionë e njëzet e katër mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar."

b) Pas pikës 3/1 shtohet pika 3/2, me këtë përmbajtje:

"3/2. Efekti financiar për vitin 2024 përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama